

BIBLIOTEKA
SHTETIT

398.8


L 95

LULE
MAJI,
MOJ
KOLONJË

*Këngë
popullore*

39
L 95

LULE
MAJI,
MOJ
KOLONJË



*këngë popullore
nga rrethi
i Kolonjës*

Mbledhur dhe përgatitur nga.

VASIL DEDE

PARTI, JE MAL I LARTË

O Parti, je mal i lartë
për ty zemra na këndon,
je besnike e marksizmit
prandaj kurrë nuk gabon.

Me ty jemi kryelartë
si flamuri që valon,
me ty çajmë çdo bllokadë
Enver Hoxhën në timon.

O Parti, je mal i lartë
për ty zemra na këndon,
me ty jemi kryelartë
si flamuri që valon.

Shtikë

SHQIPËRI, SYRI QË S'FJETE...

Shqipëri, syri që s'fjete
s'u theve nga qindra derte
t'u përplasën dallgë, shtete,
kala ishe kala mbete.
Shqipëri, yllin në ballë
krejt fytyra dritëlarë
me argjend, flori të rrallë,
rreze thith një botë mbarë.
Ballëlarta, shtatkalaja
nxjerr mendime të mëdhaja,
rruga jote njeh veç maja.
Ti flamurin nuk e ul
hiq ata ti prapë vur,
ke themelet shkëmb e gur
dhe marksizmin dritë e yll.
Shqipëri, syri që s'fjete

rrezëllin si diell në shkrepje
me Partinë tënde mbete
besnike deri në vdekje.

Kolonjë

E FUQISHME USHTON KËNGA

Sot këtu në Gjirokastrë,
në kalanë madhështore,
e fuqishme ushton kënga
edhe vallja arbërore.

Na ngroh zemrat festivali
në vendlindjen e Enverit
shkëlqen fusha, ndriçon mali
me tërë ngjyrat e ylberit.

Ndizet kënga, dridhet vallja
me hare e me gëzim
për Partinë sokoleshë,
për Enverin kryetrim.

Myzeqarë e malësorë
si vëllezër plot gëzim
zemrat thellë u këndojnë
për Partinë që na prin.

Ersekë

FENER PËR NE

Festë e madhe anembanë
delegatë nga çdo anë
mijëra revolucionarë
po të vijnë, moj Tiranë.
Gaz i madh për Shqipërinë
kudo flet për Partinë,
Kongresi i Shtatë i Partisë
është fener i punëtorisë.
Armiqtë po i kap tmerri
lufton si trim Enveri
si kundër imperializmit
ashtu dhe revizionizmit.
Shtatë kongrese Partie,
shtatë kala trimërie,
shtatë përqafime miqve,
shtatë batare armiqve.

BILBIL—O, KËNDON PËRHERË

Kujtimet të shokut H. Kapo

Vdekjezeza ty të mori
dhëmbja zemrat na i drodhi
rrjedhin ditët ujë kroji
prapë ngrihesh si dragoi.

Ti me ne ku ndizen drita,
ti me ne ku vihen prita,
ti me ne kur hapet dita,
ti te Fierza, te Bistrica...

Bilbil-o, këndon përherë,
krah shqiponje nëpër erë...
Ligjëron ti në tribunë
lë një porosi më shumë...

1979

RROFTË E QOFTË KJO PARTI

Seneja tridhjet' e nëntë
seç na ra një rrufe,
motmot e gjysmë viti
na ka pllakosur jeziti!
S'la plevicë e s'la shtëpi
vrau burra e çilimi.
Rroft' e qoftë kjo Parti,
që lufton këtë lubi!

Vrepokë

BRIGADËS SË PARË

Njëzet e ca ditë luftë në Tiranë,
të keqen e emrit, moj Brigad' e Parë,
lufton Italinë bashkë me gjermanë.
T'i futesh në top futesh në mortajë
shkatërrove Ballë me gjithë tradhtarë.
Po ikën Balli, ikën duke qarë
— Burrani, o shokë, vjen Brigad' e Parë
se ajo na vret e na zë të gjallë.
Të këtille djema, neve s'kemi parë
të gjithë të zgjedhur, gjithë vullnetarë.
— Ne Mehmet Shenë, kemi komandant,
Mehmet Shehu ynë ka luftuar n'Spanjë.
Të keqen e emrit, moj Brigad' e Parë,
kudo që po shkon ti, çliron vatanë.

Leskovik

DËSHMORE TË KOMBIT JEMI

Dëshmorë të kombit jemi,
ju të gjallëve u themi:
S'hipëm në fron dhëndërie,
s'vumë kurorë nusërie,
gjin' e mëmës s'e gëzuam,
u fejuam, s'u martuam.
Nën kushtrimin e Partisë
hymë në front të lirisë
dhe liria u fitua
dhe nga ju u gëzua.
Përmes gjuhës së të gjallit
flet dëshira e të vrrarit.

Ersekë

DO TË VIJ ME TY DHE UNË...

Do të vij me ty dhe unë
jam e fortë, duroj shumë.

Mali është plot me borë,
moj fshatarja vetullhollë.

Bëhem diell ngjitem malit
e shkri borën mes tufanit.

Do të vij me ty dhe unë
se lirinë dua shumë.

Fusha bën furtunë, baltë,
s'ke si vjen, moj, nëpër natë.

Unë rrugën e gjej vetë,
bëhem hënë dhe çaj retë...

Leskovic

NË PYESTË KU VURI KOKËN

Në pyestë ku vuri kokën,
jastëk gurin, dyshek tokën.

Në pyestë ç'ka pirë malit,
plot me shi gjurmën e kalit.


Çfarë ka ngrënë në pyestë,
bukë misri dhe pak qepë.

Në pyestë kë kishte pranë,
dhjetë shokë partizanë.

Në pyestë ç'i skuq te balli,
një lulekuqe nga livadhi.

Në pyestë ç'fjalë ka thënë,
amanetin, o moj nënë...

Postenan



SKËNDER ÇAÇI, O LULE...

Mu te Guri i Bletës, djalë, lufta seç u ndez,
Skënder Çaçi djalë, o lule,
plumbi i mallkuar, Skënder, ty seç të rrëmbeu
të rrëmbyen shokët, Skënder, o me axhele
shokëve me gojën tënde dy fjalë ç'u the:
– Luftën ta vazhdoni, djem, luftoni për atdhe.
Zylyftar Podën, o Skënder, ti e nderove
po ti nuk ke vdekur, Skënder, rron bashkë me ne.

Leskovik

JOSIF, ME ZEMËR TË KUQE

Josif,¹⁾ me zemër të kuqe
të kërkojnë dy burbuqe,
vash' e djalë më të gdhirë
kërkojnë përkëdhelinë.
Vdekja vrenjti çdo fytyrë
dhe çdo qenie në natyrë.
Jetën e mbylle me nder,
besnik i shokut Enver.

Ersekë

1) Josif Pashko

NË BARMASH ATJE MBI SHKALLË

Luftë e madhe në Kolonjë
me gjermanët po luftojnë,
në Barmash atje mbi shkallë
seç u bë goditje e parë.
Partizanët si luanë
tok me shokët vullnetarë
zunë grykat anembanë
me në krye trim Rizanë.¹⁾
Ndal, gjermanit i thanë,
ke të bësh me shqipëtarë
s'e lënë hakun pa marrë,
japin jetën për vatanë.

Novoselë

1) Riza Kodheli, Hero i Popullit

KËNGË PËR DËSHMORIN ALEKS BAKALLI

O ky Postenani, more,
në një shkëmb e breg
ka nxjerrë një trim,
një trim të vërtetë.
Aleks Babaliun
triminë me fletë,
m'u te Tendë e Qypit
pushka po kërcet.
Komandant Mehmeti
«Në sulm!» — po thërret.
T'u sosën fishekët
nxore bajonetë,
plumbi i armikut
në gjoks të godet,
shokëve dy fjalë

u le amanet.
Re siç bien burrat,
trimat e vërtetë.

Postenan

RA TËRMET E GJËMOI RREZA

Ra tërmet e gjëmoi rrëza,
dëgjoi e bukura brenda
në bashodën plot velenxa
hapi penxheretë ergjëda
fluturova vajta brënda.
Më dha bukë djathë e hëngra
më shtroi shiltenë e fjeta
për krye më shkoi shigjeta,
kur u ngrita nuk e gjeta
kishte shkuar lart në çeta...

Shqerri (Kolonjë)

MALEVE LUFTOJNË

Leskovik i bukur, mjera un' për ti,
të dogji gjermani dhe të bëri hi.
O që nga Borova deri në kufi
shkoninë fëmija me lotë në sy!..
Ka dalë Partia me shumë djem të ri
me yllin në ballë dhe s'pyesin njeri,
maleve luftojnë «vdekje a liri»,
Enveri i prin, kjo nëna Parti.

Kolonjë

NË KOLONJË KUSH LUFTONTE

Në Kolonjë kush luftonte,
kolonjarë,
dhe fashistët i dërmonte
kolonjarë?
Dhe në Blush¹⁾ kush u dha dërmën,
o blushar?
Kush e bëri vendin kërmë,
një vodicar.
Mu në Frashër, Dangëlli
o frasharë,
lufton Nasi,²⁾ djalë i ri

1) Fshat në Qesarakë (Kolonjë)

2) Nasi Vodica ilegal nga më të parët në rrethin e Kolonjës; intendent i batalionit «Hakmarrja», më vonë efektiv i Brigadës IV S. U vra në Sul të Bilishtit në Operacionin e Dimrit 1944.

një kapedan.
Mu në Sul fati të nxori,
ty vëlla,
të vret ky tradhtari
për ty qaj.
Ta-ta-ta ia bën boria
berihai,
— Të marrim hakun e tij,
thërret Zijai.

Vodicë

ALLAFRËNGA MARSÏ NJË

Allafrënga marsi një
qielli sterrë seç u bë.
Një çetë me vullnetarë
venë të rrethojnë Ballë
Një tradhtar me të katra
vjen të marrë informata
po atje s'bëri dot punë
se partizanët e zunë.
Revolen në kokë ia vunë
s'e lanë të fliste shumë.
Ish Xheviti me Jonuzë¹⁾
që s'u trembej syri kurrë.

Starje

1) Partizanë nga Kolonja, rënë dëshmorë në Gorë të Korçës.

TI IKE I VOGËL, DJALË I PARRITUR¹⁾

Ti ike i vogël, djalë i parritur,
o vëllai ynë, more yll i ndritur.
U nise nga Jugu shkove në Veri
në Lisin e Matit komisar i ri.
Furtuna s'të mposhti, dole fitimtar
ylli i heroit shkëlqen rreze ar,
si flamur i kuq do mbetesh për ne,
komisar i dritës për jetën e re.

Taç

1) I kushtohet mësuesit Ilia Qiqi

KËNGË PËR ZYLYFTAR PODËN

valle e kënduar

Thonë doli Rumelia
ngriti krye Shqipëria,
thonë doli sadrazemi
ngrihi Shqipërisë t'i vemi.
Zylyftar mustaqeverdhë,
prit nizamët se t'u derdhë.
Melesini maja-maja
e rreh topi, kumbaraja.
Burrë, o Elmas Xhemo, burrë,
më të shumtëtë me gurë.
M'u tek portë e Zylyftarit
varur kokë e bash nizamit.

KU DO TA BËJMË DIMRIN SIVJET

Ku do ta bësh dimrin sivjet?
Medet, o Riza,¹⁾ medet.²⁾
Në Shqerri përmbi Përmet
doje të nxirrje shqipen në shesh.
Ç'të kërkon Çerçizi,³⁾ more, breg më breg,
more breg më breg, po më nuk të gjet.
Nëna e babai të presin në Përmet
malihëri yt varur mbeti shkret.

Shqerri

-
- 1) Riza Velçishti
 - 2) përsëritet pas çdo vargu
 - 3) Çerçiz Topulli

LESKOVIK E MË TË DALE

Leskovik e më të dalë
të vranë, o Kollas,¹⁾ të vranë²⁾
Nexhipi³⁾ me Myrtezanë⁴⁾
nuk durojtë një të sharë.
Telefonat anembanë:
– Zini Nexhipin të gjallë!
Kishte bërë nënia djalë
nuk ziresht Nexhipi gjallë.
Erdh e morën të vëllanë,
në Përmet në hapsanë.
Nexhipi njëzet vjeç djalë
me Çerçiz e me Mihalë.

1) kolonel turk

2) përsëritet pas çdo vargu

3) Nexhip Bënja (Hysi)

4) Myrteza Kule, shoku i Nexhipit

YMER AGUA PA NJË ENDËRR

Ymer Agua pa një ëndërr
sikur iu martua vasha.

Ymer Agua i hipi kalit
e i gjeti krushqit mbudhë:

— Udhë e mbarë, o krushq të mbarë,
nusen ku e keni marrë?

— Kjo është nuse e Ymer Agës
dhe ia çojmë Ali Pashës.

— A më njeh mua, moj vashë?

— Ku tu njoha, ah, unë e mjera
një natë të fjetur,
shtatë vjet pa pjekur?

Me ç'më kishte thënë e ëma
një nishan ia kishte llëra.

Ymer Agua zbuloi krahnë,
u të keqen e nishanit.

Merrmë në vithe të kalit.
Selam Ali Pashës
doli burri vashës,
hatëri të mos i mbesë
do ti gjej një time mbesë.

LULE MAJI, MOJ KOLONJË

Lule maji, moj Kolonjë,
Erseka qyteti jonë
n'shekuj e përgjumur, plakë
tani nuse stoliartë.
Ndërtime ti ngado ke,
na u bëre krejt e re.
E re je ti në ndërtesë
për kulturë edhe jetesë,
ti je vepër e Partisë,
djersës, mundit t'puntorisë.
Zemrat tona gaz ndezin
socializmin përshëndesin.

Ersekë

LESKOVIK, BILBIL PREJ SHKËMBI

Leskovik, bilbil prej shkëmbi,
vallen, këngën ta do vëndi
syshqiponja, gojëmbli
gjoksi Melesin i tëri.

Prodhon grurë, misër, rrush
melesnikë dhe larush,
gjoksi këngë mbushur prush
vallen si ty s'e merr kush.

Leskovik sykufitari,
veshur me rroba ushtari
mbron çdo lule majë bari
kush guxon s'del jo i gjalli.

Leskovik, shqiponjë shkëmbi,
vallen, këngën ta do vëndi
ndrit fytyra dritargjendi,
syshqiponja, gojëmbli.

Leskovik

KOOPERATIVËS SË PARË NË RRETH..

Fryu erë e gjethit
na solli beharë,
në fshatrat e rrethit
kooperativë e parë.
Traktorët buçasin
ledhet po sheshojnë
armiqtë pëlçasin
me sy na shikojnë.
Dielli i ndriçuar
ngjalli bimësinë,
Partia mendoj
për fshatarësinë.

Barmash

TRËNDAFIL, O LULE BUKUR

Trëndafil, o lule bukur,
trëndafil more,
falmë gonxhen më të bukur
t'ia dhuroj un' sot Partisë
në shenjë të dashurisë.
Enverit t'ia jap në dorë
t'i uroj shtatëdhjetvjetorë.

1978

Mësiçkë

KËNGË PËR FSHATIN E RI POBICKË

Ra dielli mbi Pobickë,
dielli, o moj shoqe,
shkojmë atje të ngremë shtëpitë
të punojmë për atdhe,
kopsht i bukur lule shumë,
ejani, shoqe, me ne,
të lulëzojë fshati ynë
lule ti, Parti, na ke.
Lulëkuqet e rinisë
çelin maleve, shoqe,
çelin maleve si zjarre
zjarr të kuq, Parti, na ke.

Leskovik

ME SE LUHET VALLJA

valle e kënduar

Me se luhet valleja,
fët me sup e fët me krah,
me fustan të bukur-o,
fët me sy me vetulla.
Shih si dridhet valleja
shpejt e lehtë si flutur-o
për jetën e lumtur-o,
derdhet kënga sallës-o
për grurin e arës-o
mbushen plot hambaret-o.

Starje

SHOQE, NA THËRRET PARTIA

Shoqe, na thërret Partia
që të jemi pararojë
në çdo anë të mëmëdheut
djersën tonë të kullojmë.
Shoqe, vihuni në radhë
Shqipërinë ta bëjmë dritë!
Të punojmë me forcat tona
të punojmë natë e ditë,
armiqtë le të pëlçasin,
armiqtë le të vjellin vrer.
Ne na prin Parti e Punës
me në krye shokun Enver.

Ersekë

MOJ KOLONJË E ZBUKURUAR

Me Partinë, me Enverë
Kolonjë e bukur përherë
ndrit si një mëngjes me diell.
Në çdo fshat, kooperativë
kopështe, çerdhe për fëmijë
për atdhenë, për Partinë
rriten porsitrendafilë.
Vajzat e tua sorkadhe
korrin grurin, hedhin valle,
si në malet partizane
marshon çeta vullnetare.
Grushtshtrënguar, buzëqeshur
Kolonja llërëpërveshur
me Partinë si mal ngjeshur
drithëra rrëzave ka hedhur.

Sot të shoh të lulëzuar,
vreshta, pemë jeshiluar
vigjëlon ti pa pushuar,
moj Kolonjë e zbukuruar.

Kolonjë

KËNGË PËR MINIERËN E RE

Aty nën Bezhan doli një madem,
do të marr një copë do ta bëj kalem
do shkruaj ca fjalë këngës do t'ia them
është qymyrgur ndaj zemra më zien.
Bukë e industrisë, minierë e re
vijne varg makinat i ngarkojmë ne
vepër e Partisë, e jetës së re.

Bezhan

O BARMASH I DASHUR

Rrëzë o një mali
je ndërtuar ti,
o Barmash i dashur,
fshati yn' i ri.
Me shkollë, me kopshte,
çerdhe për fëmijë,
o Barmash i dashur,
fshati yn' i ri!
Çdo ditë e më tepër
ti po lulëzon,
o Barmash i dashur,
ore zemra jonë!

E NDËRTUAM FSHATIN

E ndërtuam fshatin
e bëm' si qytet,
Partia, nëna jonë,
rrofsh e qofsh përjetë,
me vepra sociale
me bibliotekë.
Partia, nëna jonë,
rrofsh e qofsh përjetë!
Ngritëm lapidarin,
kujtim i vërtetë,
Partia, nëna jonë,
rrofsh, ti rrofsh përjetë!

Rehovë

SHQIPTARI DUARARTË

Shqiptari duarartë,
mendjepastër ballëlartë,
pushkën fortë e mba në krah
edhe kazmën mba në dorë
frikën askujt nuk ia ka
lumturinë ka kurorë.
Shqipërisë kep më kep
tërë me libër në xhep
të bashkuar si një trup,
rrojn' me nder e jo me turp.
Prin Partia, prin Enveri
për çdo vit ngjit shkallë nderi.

Ersekë

**NË ARË PUNOJMË, NË SHKOLLË
MËSOJMË**

Në arë punojmë,
në shkollë mësojmë,
ç'ndryshime të shumta
ka ky fshati jonë.
Ne na duhet shkolla
që të kemi grurë,
misër dhe duhan,
drithëra, bukë shumë.
Në ndihmë të fshatit
mijëra qytetarë
vijnë të gëzuar
dhe punojnë në arë.
Ulen këmbëkryq

duke kuvenduar
dy klasat mike
sa shumë janë forcuar!

Qafëzez

**SEÇ KËNDON BILBILI, SEÇ KËNDON
THELLËZA**

Seç këndon bilbili
pllajës së Kolonjës,
manushaqe e prillit
në mes të dëborës.

Dil, moj, ta dëgjosh
t'i marrësh avazet,
hapi rrugë diellit
mes për mes dritares.

Ngjite lart traktorë
arës përmbi lumë
nga të gjithë shokët
kush të do sa unë?

Ç'ke që rri menduar
shoqet le të thonë,
merre qetë e shtruar
veç mua besomë.

Le të flasë fshati,
ç'të duan të thonë,
plastë nga inati
kush na zë në gojë!

Seç këndon thëllëza
rrëzë Postenanit,
dil, moj, ta shikosh
çupën e çobanit.

Me leva ndër duar
të hequr si bari
vetullën harkuar,
gushën borë mali.

Si hënë e praruar
që shndrit nëpër pyll,
synë e saj të shkruar
e hap dhe e mbyll.

Me traktor te stani
vjen e qesh me lot,
kjo çupë e çobanit
na martohet sot.

Seç këndon bilbili,
seç këndon thëllëza,
gushë trëndafili
rritur nëpër rrëza.

Gushë manushaqja
rritur në mes stanit
bilbili, thëllëza
rrëzë Postenanit.

Bilbili, thëllëza
zënë dora-dorës
këndojnë në rrëza
pllajës së Kolonjës.

Postenan

LESKOVIK, O GUR STRALLI..

Leskovik, o gur stralli
lëshon çika festivali
s'të mundi as mbret, as krajli
se s'mund të rrëzohet mali.

Leskovik, s'u theve kurrë
tri herë ta dogjën nurë
prapë lart ngrite flamurë,
mbi shkëmbinj edhe mbi gurë.

Bloqe vreshtash rreth e rrotull
si gjerdan që s'ka të sosur,
mali krahët ka shpalosur
valle, këngë nxjerr ky popull.

Me rroba aksioni veshur
përshëndet Radovë e qeshur.
Rinia llërëpërveshur
zjarr të kuq tek ti ka ndezur.

Leskovik, seç fryn një erë
vjen rinia sjell pranverë,
dritaret vështrojnë diellë
nur të ri merr ti përherë.

Leskovik

SHQIPËRI, MOJ BALLËKUQE

Pushkën supit hedhur mban,
kazmën, librin pranë e pranë
gjokszbuluar në tufan
e stuhi.

Forca jote mposht dhe malin
ti mbjell këngë, sjell beharin,
ti rrit grurin e çelë barin
me Parti.

Syri mpirë pranë pushke
përmes flake, valle pune,
Shqipëri, moj ballëkuqe
dhe krenare.

Ecën, ecën dhe nuk ndalesh
shqiponjë e rritur mes malesh
zjarr, rrufe mes shqotash, vallesh
në tufane.

Djersë, punë, këngë, valle
si diell ndrit në festivale,
moj e vogla, e madhe
ç'më je sot.

Ecën, ecën dhe nuk ndalesh
shqiponjë e rritur mes malesh
dritë e kuqe çan tufanesh
nëpër botë.

Kolonjë

**ME GISHTIN NË KËMBËZ
FITORET I MBROJMË**

Në rrëz' të Gramozit vigjëlojmë ne
popull e ushtri të mbrojmë atdhe.
Me kazmë në dorë të renë ndërtojmë
me gishtin në këmbëz fitoret i mbrojmë.
Popull e ushtri një e të pandarë
ruajmë në kufi e punojmë në arë
se zakon e kemi nga mëmë e nga atë
për armiq të ta mbajmë barutin të thatë.
Partia na lindi ushtar në beteja
ajo të kalit në ditët e reja,
tridhjetë vjet jetë ushtri popullore
që nuk njeh disfata, por vetëm fitore.

Ersekë

KËNGË TË VJETRA PËR KURBETIN

1. Ç'TË DËRGOI BURRI MBRËMË?...

| — Ç'të dërgoi burri mbrëmë,
o moj ti mollë e ëmbël?

— Shami të mëndafshtë
mbështjellë në kartë.

Me dorë s'e zura,
në kokë s'e vura,
as sytë s'ia shtyra
rashë e u sëmura.

Meqë s'erdhi vetë,
ardhtë mos më gjetë.

— Ç'të dërgoi burri mbrëmë,
o moj ti mollë e ëmbël?

Një sërë florinj
ca florinj të zinj
të mbajtur, të djegur
të vyshkur, të tretur
njëzet vjet pa pjekur...

Shqerri

2. NJË BEHAR I VOGËL...

Një behar i vogël
po na vjen sivjet,
do t'i rri më këmbë
do t'i bëj hyzmet.

Djemtë larg na mbetën
tretur në kurbet
s'u nisim dot letër
pa le muhabet.

Te pusi plot nuse
qajnë e s'mbahen dot,
kovat s'mbushen me ujë
po mbushen me lot.

Çupëzat mbetën
pa gëzim në jetë
çupa më e vogël
tridhjet' e ca vjetë.

Shqerri

3. KU JE NISUR E DO VEÇ?

Ku je nisur e do veç, djalë o peshtanlli?

Jam nisur për në kurbet, çupë moj Dudi.

A më merr mua me vete, djalë o peshtanlli?

Rruga është e gjatë e tretesh, çupë moj Dudi.

Bëhem mollë e hyj në gji, djalë o peshtanlli.

Po harroj e të kafshoj, çupë moj Dudi.

Nuk jam helm e të helmoj, djalë o peshtanlli.

Jam sheqer të ëmbëlsoj, çupë moj Dudi.

Peshtan

4. ELEGJI KURBETI

Zunë yjtë e po rrallojnë, o bir,
bir, bir Kalem, bir, bir Koçi,
bir Xhafer, mor, mos shko dhe ti!
Zunë kurbetlinjtë e shkojnë, o bir,
bir, bir Kalem, bir, bir Koçi,
bir Xhafer, mor, mos shko dhe ti
ç'doni në atë dhe të huaj, o bir,
bir Kalem, bir Koçi,
ç'fat më patët që të dy.

Mbetët larg vëllezërve tuaj, o bir,
bir, bir Kalem, bir, bir Koçi,
bir Xhafer, mor, mos shko dhe ti.
Zunë nënat t'ju vajtojnë, o bir,
bir, bir Kalem, bir, bir Koçi,

bir Xhafer, mor, mos shko dhe ti.
Zunë nuset t'ju kujtojnë, o bir,
bir, bir Kalem, bir, bir Koçi,
na latë me duar në gji
ç'deshët ju në dhe të huaj, o bir,
bir, bir Kalem, bir, bir Koçi;
bir Xhafer, mor, mos shko dhe ti.
Toka juaj është flori, o bir,
bir, bir Kalem, bir, bir, Koçi,
bir Xhafer, mor, mos shko dhe ti.

Starje

5. KU VETE, MORE I SHUAR

Ku vete, more i shuar,
neve dy muaj martuar
akoma s'jemi gëzuar
muajë e mjaltit pa shijuar.
Ku vete, mor vafsh i gjallë,
ne s'e kemi nxjerrë mallë
ç'do të thotë bota vallë?
le që kush ta qan sot hallë?
Kush e ka nxjerrë kurbenë
atë dheu mos e tretë.
Le të shuhet, të vithiset
shkojnë djemtë na shastisen,
le të shuhet, të shkretohet
shkojnë djemtë na harrohen.

Leskovik

6. ÇU NISE PËR NË JANINË

Ç'u nise për në Janinë,
leshverdha trëndelinë,
burri tënd harroi shtëpinë,
leshverdha trëndelinë.
T'i dërgojmë të na vijë,
me Balinë qiraxhinë
s'ka dërguar, haber, s'dimë,
veç një tufë trëndelinë.
Unë ato fare s'i desha
ndaj ia hodha nëpër vreshta,
Më shumë qava se qesha
do ta pres edhe një muaj
do marr shoqet e do luaj,
do të pres edhe tre ditë
pastaj do të prish shtëpitë...

Kovaçisht

7. MË ERDHI BURRI NGA KURBETI

Më erdhi burri nga kurbeti,
moj, merak ç'më mbeti,
më erdhi në shtëpi s'më gjeti
u ndodha në derë të tim eti.
Dera e tim eti u shkretoftë!
Do të dal të pyes botën:
Kush ia hapi atij portën?
Do të dal të pyes fshatin:
Kush ia shtroi atij krevatin?

Cerokë

NINULLË DJEPI

Nina-nana fli, moj kukull,
mbylli sytë e bukur,
bukuroshe e valës-o,
në ç'ëndrra je futur?
Nina-nana fli, moj kukull,
bëfsh gjumin e ëmbël
të puth rreze hënës
gushën nëpër ëndërr
këmbë e duar si rrodhan.
Nina-nana, more xhan,
fli dhe ca të rritesh-o
të shkosh lart me shokët-o.

Postenan

KËNGË DJEPI

Nano-nano djalënë
se na zgjoi mëhallënë!
Kush e ka e kush e do,
kush e përkëdhel kur do?
Djal'i vogël këto do,
lodrat edhe vallet-o!
O nanan, o nanan,
nëna t'u bëftë kurban,
që të ka e që të mban.
Ririri, ririri,
kush të ka more flori?
Ty të ka nënua në gji.
Nano-nano djalënë
që na zgjoi mëhallënë.

Të ligat i mori lumi,
dhe i shpuri te Osumi
djalin na e zuri gjumi.

Kolonjë

KËNGË PËR ÇOBANKËN E MALIT

U lodhë, çobankë, u lodhe, çobankë, u lodhe,
të përpjetën e malit kur more
torbën vllahçe supit hodhe
majë malit sëç qëndrove,
pranë stanit sëç pushove,
me çobanin bisedove.
O çoban, çoban i malit,
do qëndrojmë të dy stanit;
o çobankë, bashkë çupave
do qëndrojmë të dy tufave.
Sevdaja stanit ka lezet
qengja plot e qumësht det.

Starje

THËLLËZË E BUKUR NË SHKËMB

Thëllëzë e bukur në shkëmb,
kur dëgjova zënë tënd
shastisa mbeta në vënd.
Hape mbylle tarabanë¹⁾
të shikosh ca djem beqarë,
ti thëllëzë e unë djalë.
Zënë e bukur kur këndon
ma kënda të të dëgjoj,
hape mbylle tarabanë
të shikosh ca djem beqarë.

Postenan

1) dritaren

TË PASHË S'TË NJOHA

Shaminë e murme dy gisht përmbi vetull
të pashë e s'të njoha, gështenjë e papjekur,
thashë se s'të njoha, ndryshe më je veshur
sa më qenke ligur, sa më qenke tretur,
të pashë e s'të njoha, gështenjë e papjekur.

Postenan

AFËR XHAMIT TE PENXHEREJA

Afër xhamit te penxhereja
i vura një copë letër;
ç'do të thotë vallë esmerja
kur ta lexojë të shkretën?
Ç'do të thotë qerpikdrejta
kur të çohet në mëngjes
e të hapë penxherenë
duke fshirë sytë e zez?

Vetullhollë moj esmere,
afër xhamit e' ke letrën,
çdo mëngjes kur hap penxheren
kujtomë një çast të vetëm.

Postenan

MOJ E VOGËLA NË LËMË

Moj e vogëla në lëmë, moj e vogëla,
ç'të zbardhojnë ato llërë, moj e vogëla,
as m'i jep t'i bëj gjilpërë, moj e vogëla,
të qëndis pajën e tërë, moj e vogëla,
moj e vogëla si floriri, moj e vogëla,
ç'të shkëlqen gusha dhe gjiri, moj e vogëla.

AS MË THUA NJË FJALË

Porsi dash manare
rri në fund të odës,
as më thua një fjalë,
të keqen e gojës.

Dymbëdhjetë unaza
në gishtërinjtë e dorës,
lum kush do ta marrë
selvinë e Kolonjës.

Manushaqe prillit
në mes të dëborës,
as më thua një fjalë,
të keqen e gojës.

Konçishtit

KËNGË PËR ÇUPAT DHE NUSET E SHQERRISË

Çupat e Kreshovës
berzelike dorës,
ububu e obobo,
ma kanda të los me to.
Çupat e Kovaçishtit
rreth unaza gishtit,
ububu e obobo
ma kanda të los me to.
Çupat e Izgarit
me florinj pas ballit,
ububu e obobo
ma kanda të los me to.
Nuset e Delvinës
bytyn lule linjës,
ububu e obobo,

ma kanda të los me to.
Nuset e Labovës
si top i dëborës,
ububu e obobo,
ma kanda të los me to.

Kovaçisht

MË RRËMBEU BEQAR I MALIT

Më rrëmbeu beqar i malit, moj nënë, më rrëmbeu,
më hodhi në vithë të kalit, moj nënë, më rrëmbeu.
Më mori florinë e ballit, moj nënë, më rrëmbeu.
Lerma se e kam të djalit, moj nënë, më rrëmbeu.
Më rrëmbeu beqar i fushës, moj nënë, më rrëmbeu,
më hodhi në vithë të mushkës, moj nënë, më
rrëmbeu,
më mori florinë e gushës, moj nënë, më rrëmbeu.
Lerma se e kam të çupës, moj nënë, më rrëmbeu.

Kolonjë

KJO NUSE QË ERDH' KËTUNË

Kjo nuse që erdh' këtunë
erdh' me hënëzë në gji
zbukuroi këtë shtëpi.
Kjo nuse që erdh' këtunë
erdh' me hënëzë në ballë
zbukuroi këtë mëhallë.

ZURA NJË BILBIL ME VESE

(Këngë e vjetër)

Zura një bilbil me vesë, bilbil-o,
në parmak të penxheresë, bilbil-o,
kam frikë se mos më vdesë, bilbil-o.
Dhe në vdektë mos e qani, bilbil-o,
as me ujë mos e lani,
As me ujë, as me verë
po me lot t'asaj të mjerë, bilbil-o.

Kovaçisht

Ç'MË VINJE NGA KORÇA ME KALË TË BARDHË

Ç'më vinje nga Korça me kalë të bardhë,
Thomaidhë e nënës prishe mënç dynjanë.
Në majë të Qarrit ndërrove fustanë,
dole në Lipeç dhe pe Postenanë
çupë nga qyteti, nuse në Pacanë,
dashuri e shkretë mbi këtë anë
me bandill Ilinë, me atë çobanë,
Thomaidhë e nënës prishe mënç dynjanë...

Postenan

SHAMINË QË TA DËRGOVA

— Shaminë që ta dërgova,
nuse moj, a ta suallë?

— Ma suall të lumtë dora,
shumë jam gëzuarë.

Se djali që ta dërgoi
të puth synë e shkruarë,
më thanë s'e begenise,
moj nuse fodulleja,
mblodhe shoqet qesëndise,
moj nuse fodulleja.

— Jo, o trim, mos kem njeri
këto llafe nuk i di.

Jo, o trim, mos kem baba
isha poshtë u ngjita la.

Jo, o trim, mos kem nënë
mal ma bëre mua zemrën...

Peshtan

PRIT, BABË E NËNË, SA TË BËHET DITË

Të hodhë stolitë seç të erdhi frikë
dhe babai të tha: Ngreu, çupë, e ikë!
Dale, baba, dale, dale dhe një çikë,
prit, o baba, prit, sa të bëhet ditë.
Të veshnë fustanë se ç'të erdhi frikë
dhe nëna të tha: Ngreu, çupë, e ikë!
Dale, nënë, dale, dale dhe një çikë,
prit, o nënë, prit, sa të bëhet ditë.

Gjerakorë

ZBRET THËLLËZË E MALIT

Zbret thëllëzë e malit, zbret duke kënduar,
leshtrat kaçurrela sup më sup lëshuar.

— Ç'ke, moj nusja jonë, që rri e menduar?

Ti more një burrë përmbi shokët shkuar,
për punë e këngë s'ka të krahasuar,

një dynja e tërë atë ka gojuar,

ç'ke, moj nusja jonë, që rri e menduar?

Peshtan

TATËPJETË BREGUT VIJE..

Tatëpjetë bregut vije
si thëllëza shkëmb mbi shkëmb
unë pranë shtegur rije
kur dëgjova zërin tënd.

Thashë se vije tek unë,
moj e reja kombaniere,
ti vije ku kishe punë,
flokëgrurja kaçurrele.

Të korrje arën mbi lumë,
duararta kombaniere,
kallinjtë ç'm'i puth në buzë,
flokëverdha kaçurrele.

Tatëpjetë bregut vije
si thëllëza maj gurit
ecje rrugës dhe këndoje,
kënga hynte përmes grurit.

Rendëm bashkë nëpër fushë
ti përpara, unë pas teje,
buzët qeshnin nëpër grurë,
flokëgrurja kaçurrele...

Postenan

KAM NJË JAVË GJER SI SOT

Kam një javë gjer si sot,
o moj trumba borzilok,
të kërkoj e s'të gjej dot
s'të gjej dot e qaj me lot,
të kërkoj, moj, rreth pas fushës
të të var florinë e gushës,
të kërkoj, moj, rreth pas malit
të të var florinë e ballit,
të kërkoj, moj, rreth pas fisit
të të vë unazën gishtit,
unazën, moj, të nishanit,
të djalit, atij beqarit...

Postenan

MORE TRËNDAFIL

Trëndafil, m'i more mendtë,
more trëndafil.
Si m'i more, ku m'i shpure,
more trëndafil?
Seç ia dhe një plakë në udhë,
more trëndafil.
Është plak ç'e dua unë,
more trëndafil,
e dua djalë për punë,
more trëndafil,
të mbajë plumb e barunë,
more trëndafil.

Vrëpckë

Ç'JANË NJA TRE MALE

Ç'janë nja tre male, o radhë më radhë,
ç'janë nja tre çezma, more, për matanë.
O po jemi mbledhur martojmë një djalë
ky babai i djalit sa është gëzuarë
se ka djalin, more, o për të martuarë.
Të na trashëgohet, shkoftë jetë të mbarë
pastë lumturi dhe faqe të bardhë,
bëftë plot fëmijë, mbushtë një mëhallë,
o po jemi mbledhur martojmë një djalë...

Cerckë

BILBILI NJË COPË ZOG

Bilbili një copë zog
kur këndon thërret me fort,
bilbili një dorë pendë
seç e ka këngën të rëndë.
O bilbil, ta bëra benë,
në ta gjeça dot folenë,
do ta prish, ta bëj rrëmuje
se na le nuset pa gjumë.
O bilbil, ta bëra benë,
në ta gjeça dot folenë,
do ta prish, ta hedh në lumë
se na le çupat pa gjumë...

Lashovë

SALUSHE, MOJ SALUSHE

(valle e kënduar)

Salushe, moj Salushe
një okë e gjysmë balake,
një okë e gjysmë e pesëdhjetë
ja hajde, ja të vij vetë,
një okë e gjysmë me kandar
ja hajde, ja të të marr,
një okë e gjysmë e pesëdhjetë
ja hajde, ja të vij vetë,
do vij vetë, vet' i tretë...

Postenan

KUR MERR SITËN E GATUAN

Kur merr sitën e gatuan
mesin e hollë ma luan
si gatuan, për kë gatuan,
moj e vogël sa një thua.
Ti gatuan, moj, për mua
që më do edhe të dua...

SHKON ME KOKËN LART

Shkon me kokën lart
pse s'ma bën me dorë,
moj vetullrënduar?
Shamia e hollë
të zbardh si dëborë,
mbi vetull lëshuar.

Pa ndalu një çast
folmë, moj, një fjalë
ç'më rri zëmëruar?
Më dëgjo veç mua,
llafazanet janë
për të ngatërruar.

Si durojmë ne
që s'flasim me gojë
dy fjalë lëshuar,
eja dalim bashkë
rendim përmes arës
me grurë rënduar.

Eja dalim bashkë
rendim përmes fushës,
moj shamilëshuar,
lidhur dora-dorës,
lidhur gusha-gushës
përjetë dashuruar.

Postenan

LULE TI, LULE JOT ËMË

Lule ti, lule jot ëmë, lule, moj lule,
a mban mend se ç'të kam thënë, lule, moj lule?
Unë ty, moj, mos t'u ndafsha
si lisi në mal u thafsha, lule, moj lule,
më çafshin më bëfshin dhoga, lule, moj lule,
më bëfshin magje për rroba, lule, moj lule,
më shpënçin krua më krua
të lajnë vashat mbi mua, lule, moj lule.

Shqerri

TE PORTA TË SHKOVA

Te porta të shkova pse s'më kuvendove,
vetullat m'i ule me inat vështrove
| oshëtima jote kur del nga divani
| si dallgë pampori të hidhet fustani.
Na shaminë time, ngrehu hiq një valle,
| trëndafil kërmezi, erë portokalle
nga gjumi kur ngrihesh në drekë të madhe
penxheret e larta më s't'i arrij dot
mbushur pataksilë, plot me borzilok...

Cerckë

BËJ KONAK, MOJ GJERAQINË

- Bëj konak, moj gjeraqinë, bëj konak,
shtroi odat me qilimë, bëj konak,
se vijnë krushqit të rrinë, bëj konak.
- Të vijnë, mirë se të vijnë, bëj konak,
pa ta bëj veç të kem trimë, bëj konak.

LUMJA TI, KUMBULL E BARDHË

Lumja ti, kumbull e bardhë,
lumja ti ku mbive ti,
vajte mbive në vëri
aty s'të këput njeri,
veç burri me trimëri.
Lum për vjehrrën që gjen ti
llokumet t'i ruan në gji...

Lashovë

JELEKVERDHA VESHURË

Tatëpjetë bregut vije,
jelekverdha veshurë.
Thashë se vije tek unë
dola duke qeshurë.
Ti vije ku kishe punë
ika zemëruarë.
Djalë, në të mbet' hatri
kthehem ndaj të shkuarë,
janë vrarë e prerë
dhe janë pajtuarë,
ne as vrarë as prerë jemi
rrimë zemëruarë.

Zguralec (Shqerri)

PSE M'I MBAN SYTË PËRDHE

(Pse m'i mban sytë përdhe,
moj faqe portokalle,
keq të vjen a turp më ke?
Më vjen keq për nënën-e.
Hajde ti nuse me ne,
nënë kemi dhe atje
hajde ti nuse me ne,
jepi babës ti raki
plase, lere në shtëpi.

LULE MANUSHAQJA¹⁾

(valle e kënduar)

Këndon qyqja mbi shkëmb
pa dëgjoni si ia thotë.
Fjata, moj mushata,
lule manushaqja
trimat që lashë vjet
erdha t'i martoj sivjet.
Të dy duart plot e plot,
plot lule, plot borzilok
si vesë, si ves'e vesuarë
si tre vjet, si tre vjet veruarë,
si vesë, si ves'e vesiturë
si tre vjet gjesdisurë.
Nusetë që lashë vjet

erdha t'i gëzoj sivjet,
plakatë që lashë vjet
erdha t'i pleqëroj sivjet.

Rehovë

1) motiy i shkuar

TI, MOJ VETULLKAPËRCYERË

(motiv i shkuar)

Un' të thashë, moj e mjerë, të mos dalç atje
se fryn veriu të ngre çemberë, pa çë kush të sheh
çë kush më të sheh, lule, e të pikas,
n'ato penxhere të bardha me kafas
me kafas edhe me bojë lyerë
ti, moj vetullkapërcyerë,
sy dhe vetull nakatosurë,
na ke vrar' e na ke sosurë
me dy plumba të helmosurë.

Gjerasorë

MË PIKU ZEMRA, MË PIKU...

Më piku zemra, më piku
për kumatën që më iku
erdhi e rrëmbeu miku
në kalë të bardh' ashiku,
Moj kumatë, moj fatbardhë,
pa dëgjomë, moj, një fjalë.
Bregut kur të dalç matanë
një dyfek zbraz sa më parë.
Keq për nënën mos të vijë,
nënën e mbaj vetë mirë...

Cerckë

O MOJ TI ME ATË KAZAN

O moj ti me atë kazan,
të jap kondon¹⁾ a ma lan?
Unë ta laj, more i mjerë,
po kam frikë nga ime vjehrrë.
Kam një vjehrrë, një të ligë
nuk të lë të rrish një çikë.
Unë ta laj aman, aman,
po vjehrra burrit m'i shkruan
dhe pastaj më hedh nigjan.²⁾

Postenan

1) këmishë

2) pjesë (e ka kuptimin më ndan, më lë)

PASQYRA E LËNËS


Parti, je mal i lartë	3
Shqipëri, syri që s'fjete	4
E fuqishme ushton kënga	6
Fener për ne	8
Bilbil-o, këndon përherë	9
Rroftë e qoftë kjo Parti	11
Brigadës së Parë	12
Dëshmorë të kombit jemi	13
Do të vij me ty dhe unë	14
Në pyestë ku vuri kokën	16
Skënder Çaçi, o lule	18
Josif, me zemër të kuqe	19
Në Barmash atje mbi shkallë	20
Këngë për dëshmorin Aleks Bakalli	21
Ra tërmet e gjëmoi rrëza	23
Maleve luftojnë	24
Në Kolonjë kush luftonte	25
Allafrënga marsi një	27
Ti ike i vogël, djalë i parritur	28
Këngë për Zylyftar Podën	29
Ku do ta bëjmë dimrin sivjet	30
Leskovik e më të dalë	31

Ymer Agua pa një ëndërr	32
Lule maji, moj Kolonjë	34
Leskovik, bilbil prej shkëmbi	35
Kooperativës së parë në rreth	37
Trëndafil, o lule bukur	38
Këngë për fshatin e ri Pobickë	39
Me se luhet vallja	40
Shoqe, na thërret Partia	41
Moj Kolonjë e zbukuruar	42
Këngë për minierën e re	44
O Barmash i dashur	45
E ndërtuam fshatin	46
Shqiptari duarartë	47
Në arë punojmë, në shkollë mësojmë	48
Seç këndon bilbili, seç këndon thëllëza	50
Leskovik, o gur stralli	53
Shqipëri, moj ballëkuqe	55
Me gishtin në këmbëz fitoret i mbrojmë	57

KËNGË TË VJETRA PËR KURBETIN

1. Ç'të dërgoi burri mbrëmë?	58
2. Një behar i vogël	60
3. Ku je nisur e do veç?	62
4. Elegji kurbeti	63
5. Ku vete, more i shuar	65
6. Ç'u nise për në Janinë	66
7. Më erdhi burri nga kurbeti	67
Ninullë djepi	68
Këngë djepi	69
Këngë për çobankën e malit	71

Thëllënzë e bukur në shkëmb	72
Të pashë s'të njoha	73
Afër xhamit te penxherja	74
Moj e vogëla në lëmë	75
As më thua një fjalë	76
Këngë për çupat dhe nuset e Shqerisë	77
Më rrëmbeu beqar i malit	79
Kjo nuse që erdh' këtunë	80
Zura një bilbil me vesë	81
Ç'më vinje nga Korça me kalë të bardhë	82
Shaminë që ta dërgova	83
Prit, babë e nënë, sa të bëhet ditë	84
Zbret thëllëzë e malit	85
Tatëpjetë bregut vije	86
Kam një javë gjer si sot	88
More trëndafil	89
Ç'janë nja tre male	90
Bilbili një copë zog	91
Salushe, moj Salushe	92
Kur merr sitën e gatuan	93
Shkon me kokën lart	94
Lule ti, lule jot ëmë	96
Te porta të shkova	97
Bëj konak, moj gjeraqinë	98
Lumja ti, kumbull e bardhë	99
Jelekverdha veshurë	100
Pse m'i mban sytë përdhe	101
Lule manushaqja	102
Ti, moj vetullkapërcyerë	104
Më piku zemra, më piku	105
O moj ti me atë kazan	106



Lule mali moj Kolonjë. Këngë popullore nga rrethi i Kolonjës (Përg.: V. Dede, Red. L. Rexhepi), T., «Naim Frashëri», 1980.

112 f.

(*B.m.*) dhe

(*B.v.*): 398.8 (=919.83)

L 95

Tirazhi 1500 kopje Formati 70x100/32 Stash: 2204-79

KOMBINATI POLIGRAFIK Shtypshkronja e re Tiranë, 1980